

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.02.2025*

**24.02.2025
Ora, 12:47**

RENDI I DITËS

**Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 3, depozituar nga
Qendra Qëndresa Qytetare**

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.**

Znj. I. Osmanaj: Përshendetje! Sot më datë 24 shkurt 2025, ora 12:47 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr.3, depozituar nga Qendra Qëndresa Qytetare. Objekt i kërkesës ankimore është: “shfuqizimi i vendimit nr.129, datë 20.02.2025 të KSHZ. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14, të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në një prej tyre është shënuar kërkesa ankimore dhe katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë dhe më pas në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga administrata e KQZ-së, të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre për përcaktimin e relatorit. Goglat futen në enën transparente, pasi përziejmë goglat, vazhdojmë me rendin alfabetik ngjitës, duke filluar nga:

1. Zoti Elvin Lako - shiriti është i bardhë dhe pa shënime
2. Zoti Elvis Çefa - shiriti është i bardhë dhe pa shënime
3. Zoti Ilirjan Rusmali - shiriti është i bardhë dhe pa shënime
4. Zoti Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime
5. Zoti Ledio Braho - Kërkesa ankimore nr. 3

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.02.2025***

Në përfundim të procedurës së shortit për përcaktimin e relatorit për kërkesën
ankimore nr. 4, relator është zoti Ledio Braho.

Faleminderit!

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***

